



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**Këshilli i Lartë i Drejtësisë**  
**Sekretar i Përgjithshëm**

Bulevardi "Zogu I", Tiranë,

Tel: +355 42259817, Fax: +355 42259822

www.kld.al

Nr. 3874 Prot.

Tiranë më, 18.12. 2015

**L ë n d a :** Dërgohet informacion.

**Drejtuar:** Z. Dorian Matlija

**Qendra " Res Republika"**

**" Bulevardi Gjergj Fishta", Nd.24, H.3, Ap.44, kati 9,**

**TIRANË**

Në përgjigje të shkresës tuaj me nr.3874 prot, datë 09.12.2015, drejtuar Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me anë të cilës kërkon informacion, bazuar në të dhënat që disponon Drejtoria Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit, ju përcjellim informacionin sa më poshtë vijon:

Për periudhën Janar – Dhjetor 2015, nga Ministria e Drejtësisë kanë ardhur 16 kërkesa për procedim disiplinor ndaj 13 gjyqtarëve. Nga të cilat 11 kërkesa janë në proces shqyrtimi, për 1 gjyqtar është ndërprerë procesi disiplinor nga Ministri i Drejtësisë dhe 1 gjyqtari i është dhënë masë disiplinore. Gjithashtu janë 7 kërkesa për procedim disiplinor ndaj 7 gjyqtarëve të cilat KLD-ja ja ka përcjellë Ministrisë së Drejtësisë nga të cilat: për dy gjyqtarë Ministri i Drejtësisë ka vlerësuar mos fillimin e procedimit disiplinor, për 2 gjyqtar pritet përgjigje nga Ministria e Drejtësisë dhe për tre gjyqtar shqyrtimi është në proces.

Nga Inspektorati i KLD-së realizohet verifikimi paraprak për çdo ankesë të ardhur pranë institucionit. Për vitin 2015, janë paraqitur 809 ankesa nga të cilat kanë dalë urdhër verifikimi për 176 raste. Nga këto 176 raste, 47 raste kanë si objekt mosrespektimin formal të ligjit; 32 raste kanë si objekt shkeljen e etikës; 66 raste për zvarritje gjykimi dhe rastet e tjera për mos përdorim sistemi audio, shkelje proceduralë, etj. Pas verifikimit është vendosur përcjellja e 3 rasteve pranë Ministrisë së Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj 3 gjyqtarëve nga të cilët 1 rast ishte për zvarritje gjykimi dhe dy raste për shkelje etike. Nga këto raste, MD ka sjell për shqyrtim për procedim disiplinor 1 gjyqtar për zvarritje të procesit gjyqësor e cila pritet të shqyrtohet në mbledhjet e ardhshme. Gjithashtu, është verifikuar veprimtaria e 41 gjyqtarëve në bazë të informacioneve të dërguara nga Kryetarët e Gjykatave.

Kërkesa të shqyrtuara për masat disiplinore dhe shkeljet e kryera janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	GJYQTARI/JA	GJYKATA	MASA DISIPLINORE	VENDIM KLD	ARSYE
1.	O.A	Gjykata e Rrethit Gjirokastrë	“Vërejtje me paralajmërim”.	Nr. 20, date 03.03.2015	Shkelje e dispozitave urdhëruese procedurale dhe zvarritje të veprimeve procedurale
2.	A. J.	Gjykata e Rrethit Gjirokastrë Dibër	“Vërejtje me paralajmërim”.	Nr. 19, date 03.03.2015	Mungesë e arsytimit të vendimeve gjyqësore
3.	N. C.	Gjykata e Rrethit Gjirokastrë Tiranë	Rrëzim i kërkesës për masën disiplinore “Vërejtje me paralajmërim”.	Nr. 18, datë 04.02.2015 Ministri nuk propozon masë tjetër sipas rregullores për procedim disiplinor	Zvarritje në gjykimin e çështjeve
4.	P.F.	Gjykata e Rrethit Gjirokastrë Elbasan	Rrëzim i kërkesës për masën disiplinore “Vërejtje me paralajmërim”.	Nr. 21, datë 03.03.2015 Ministri nuk propozon masë tjetër sipas rregullores për procedim disiplinor	Vonesë në depozitimin e vendimit e arsytuar
5.	P. A.	Gjykata e Rrethit Gjirokastrë Lezhë	Rrëzim i kërkesës për masën disiplinore “Vërejtje me paralajmërim”.	Nr. 22, datë 03.03.2015 Ministri nuk propozon	Shkelje në veprimtarinë gjyqësore



				masë tjetër sipas rregullores për procedim disiplinor	
6	Sh.Ç.	Gjykata e Rrethit Gjirokastrë Berat	“Vërejtje me paralajmërim”.	Nr. 80, datë 18.07.2015	Mungesë e arsytimit të vendimeve gjyqësore.
7	E.Gj.	Gjykata e Rrethit Gjirokastrë Tirana	“Shkarkim nga Detyra”	Nr. 81, datë 18.07.2015	Mungesë e arsytimit në punë dhe mungesë e arsytimit të vendimeve gjyqësore.

Duke ju uruar një ditë të mbarë,

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

  
**PJERIN PRENDI**

